

P.nr. 123/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Z. R. me vendbanim në fshatin Ll. K. Gj., për shkak të veprës Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 38/2016, të datës 11.01.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurorja Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 25.10.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri Z. R., nga i ati I., e ëma Xh., e lindur N., i lindur ..., në fshatin Ll., ku dhe jeton, ka të kryer ..., ... punë, i martuar-baba i ... fëmijëve, i gjendjes ekonomike të varfër, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa gjykuar për vepra tjera penale dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse më dt....2015, rreth orës ... minuta, në pyllin e pronësisë shtetërore në vendin e quajtur “...” në fshatin Ll., i pandehuri me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 147 copë trungje të njoma të llojit bung, me diametër në cung 8-10 cm, në lartësi të drurit 7 cm, në gjatësi 5 m, si dhe me vëllim të përgjithshëm 2.34 m kub, me ç’ rast të dëmtuarës APK zyra në Gjilan i ka shkaktuar dëm material në shumë prej rreth 299 euro.

me çka ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 50, 51, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton,

DENIM ME KUSHT

I. Të akuzuarit Z. R., i caktohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 100 (njëqindë) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

III. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

IV. Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Kundër të akuzuarit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njejtë ka kryer veprën penale lëndore të përshkruara më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor. Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar shqyrtimin fillestar duke i ftuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë në këtë qështje penale.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 21.10.2016, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan Kujtesa Fazliu në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti dënojë sipas ligjit.

I pandehuri Z. R. deklaron: e ndiej veten fajtor dhe jam penduar thellë për këtë veprë , më parë nuk kam kryer veprë tjetër penale dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, jam i gjendjes së varfër ekonomike dhe për këtë arsye i kemi prerë drutë për nevoja personale , pasi që ka qenë stina e dimërit dhe nuk kemi pasur dru dhe kunatën e kemi pasur të sëmurë ku edhe tani është e ndjerë dhe e lus gjykatën që të ma shqiptoj një dënim sa më të butë.

Në fillim të shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, i akuzuari Z. R. ka deklaruar e pranojë fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Gjykata, pas dëgjimit të Prokurorit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, nga se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari Z. R., ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-s, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për të njëjtin janë përgjegjës penalisht.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata të akuzuarin Z. R., e shpalli fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-s ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale në fjalë dhe se për të njëjtin është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KP-s, si rrethana lehtësuese, e ka marrë për bazë sjelljen e mirë të akuzuarit gjatë mbajtjes së shqyrtimit fillestar, pranimin e fajësisë, është penduar, më parë nuk ka kryer vepra penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale, është i gjendjes ekonomike të varfër, kurse si rrethanë rënduese, të merret shkalla e përgjegjësisë penale, rrezikshmëria shoqërore dhe dëmi i shkaktuar të dëmtuarës.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me kusht, ndaj të akuzuarit Z. R., është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK-s.

Në kuptim të nenit 368 të KPP palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, kurse vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 123/2016, Më 25.10.2016

Sekretarja juridike
Igballe Azemi d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE :Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj Gjykate.